



Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë



RAPORT VJETOR INSTITUCIONAL

SIGURIMI I BRENDSHËM I CILËSISË
DHE AKREDITIMIT

Në zbatim të Udhëzimit nr. 5, datë 19.02.2018 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit

PUNUAN:

Përgjegjëse: Sonila BËSHTIKA

Specialiste raportimi:

Harikla BEDULI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

RAPORTIM VJETOR

I UNIVERSITETIT “ISMAIL QEMALI” VLORE

VITI AKADEMIK

2024-2025

VLORE

PUNUAN:

PËRGJEGJËSE
SONILA BËSHTIKA

SP. RAPORTIMI
HARIKLA BEDULI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	6
SENATI AKADEMIK	7
<u>TABELA 1: PËR REALIZIMIN E QËLLIMEVE DHE OBJEKTIVAVE NË FUSHËN E MËSIMDHËNIES</u>	8
TABELA 2: PËR REALIZIMIN E QËLLIMEVE DHE OBJEKTIVAVE NË FUSHËN E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT	23
TABELA NR. 3: MBI BASHKËPUNIMIN NDËRINSTITUCIONAL NDËRKOMBËTARE	27
BASHKËPUNIMIN NDËRINSTITUCIONAL KOMBËTARE	34
TABELA NR. 4: MBI PROJEKTE E KËRKIMIT SHKENCOR NË TË CILAT IAL KA APLIKUAR PËR FINANCIM.	40
<u>III) PRODUKTET NË FUSHËN E KËRKIMIT SHKENCOR TË PARAQITURA NË FORMËN E BOTIMEVE SHKENCORE, ARTIKUJVE, PROJEKTEVE TË FITUARA DHE TË REALIZUARA, PJESËMARRJES NË VEPRIMTARI BRENDA DHE JASHTË VENDIT, VEPRIMTARI SHKENCORE TË ORGANIZUARA NGA NJËSIA BAZË, BASHKËPUNIME ME INSTITUCIONE TË TJERA NË NIVEL VENDOR, KOMBËTAR APO NDËRKOMBËTAR TË SHOQËRUARA ME TË DHËNA MBI DATËN, VENDIN DHE PJESËMARRËSIT;</u>	44
TABELA NR. 5: MBI AKTIVITET E KËRKIMIT SHKENCOR TË REALIZUARA.	45
ARTIKUJ SHKENCOR ME SCOPUS PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025	46
TABELA NR. 6: MBI INFRASTRUKTURËN E KËRKIMIT SHKENCOR.	50
TABELA NR. 7: MBI PROGRAMET E STUDIMIT.	50
NDRYSHIMET NË STATUTIN APO RREGULLORET E IAL-SË, SI DHE TË DHËNA PËR NJËSINË E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË (SSBCA).	62
TABELA NR. 8: MBI VEPRIMTARINË E NJËSISË SË BRENDSHME TË SIGURIMIT TË CILËSISË (SSBCA) TË DHËNA TË PËRGJITHSHME NË LIDHJE ME RAPORTET E VLERËSIMIT TË MËSIMDHËNIES, TË NXËNIT, ETJ	64
	71



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

TABELA NR. 9: PËR ANGAZHIMIN E PERSONELIT AKADEMIK	76
TABELA NR. 10: PËR GJURIMIN E STUDENTËVE QË KANË PËRFUNDUAR STUDIMET.	86
TABELA NR. 11: MBI PËRBËRJEN E KËSHILLAVE STUDENTORË	87
TABELA NR. 12: MBI STUDENTËT QË KANË QENË ANËTARË DHE PËRFAQËSUES NË ORGANET E IAL-SË.	87

I) VLERËSIME TË IAL-SË DHE REKOMANDIME TË MUNDSHME PËR MINISTRINË, SI DHE NJË PËRSHKRIM TË NDËRVEPRIMIT TË IAL-SË ME STRUKTURAT E VARËSISË TË MINISTRISË.

89

1. VLERËSIME TË PËRGJITHSHME PËR PERFORMANCËN E UV-SË	89
1.1. CILËSIA AKADEMIKE DHE PROGRAMET STUDIMORE	89
1.2. KËRKIMI SHKENCOR DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR	89
1.3. QEVERISJA UNIVERSITARE DHE MENAXHIMI	89
1.4. MARRËDHËNIET ME KOMUNITETIN DHE TREGUN E PUNËS	89
1.5. NDIKIMI NË ZHVILLIMIN E RAJONIT	89
2. REKOMANDIME TË MUNDSHME PËR MINISTRINË E ARSIMIT	90
2.1. MBËSHTETJE INFRASTRUKTURE DHE LABORATORIKE	90
2.2. RRITJA E FONDEVE PËR KËRKIM SHKENCOR	90
2.3. PËRFORCIMI I DIGJITALIZIMIT DHE SISTEMEVE TË INFORMACIONIT	90
2.4. FORCIMI I LIDHJES ME TREGUN E PUNËS	90
2.5. MBËSHTETJE PËR NDËRKOMBËTARIZIMIN	90
3. NDËRVEPRIMI I UV-SË ME STRUKTURAT E VARËSISË SË MINISTRISË	90
3.1. ME ASCAL (AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË)	90
3.2. ME DREJTORINË E ARSIMIT TË LARTË NË MINISTRI	90
3.4. ME AKKSHI (AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR)	90
3.5. ME QENDRËN E SHËRBIMEVE ARSIMORE/REGJISTRAT KOMBËTARË	91

J) TË DHËNA MBI STUDENTËT:

91

TABELA NR. 13: MBI NUMRIN E PËRGJITHSHËM TË STUDENTËVE.	91
---	----

IV) NUMRIN E STUDENTËVE TË ÇREGJISTRUAR OSE TË TRANSFERUAR, TË SHOQËRUAR ME INFORMACION MBI INSTITUCIONIN DHE PROGRAMIN E STUDIMIT TË PARË DHE PROGRAMIN E STUDIMIT KU TRANSFEROHEN;

94

TABELA NR. 14: MBI NUMRIN E STUDENTËVE TË ÇRREGJISTRUAR DHE TRANSFERUAR.	94
TABELA NR. 15: MBI NUMRI I STUDENTËVE TË CIKLIT TË PARË QË PËRFITOJNË BURSË SIPAS VKM NR. 903, DATË 21.12.2016 (PËRDITËSUAR) TË NDARA SIPAS KRITEREVE.	96
TABELA NR. 16: MBI NUMRIN E STUDENTËVE TË CIKLIT TË PARË QË PAGUAJNË TARIFË (50% OSE	97



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

100%) SIPAS VKM NR. 288, DATË 21.05.2018 (PËRDITËSUAR) TË NDARË SIPAS KRITEREVE.	97
TABELA NR. 17: MBI NUMRIN E STUDENTËVE TË CIKLIT TË PARË QË PËRJASHTOHEM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT, SIPAS VKM NR. 269, DATË 29.03.2017 (PËRDITËSUAR) TË NDARË SIPAS KRITEREVE.	98
TABELA NR. 18: MBI NUMRIN E STUDENTËVE TË CIKLIT TË DYTË QË PAGUAJNË TARIFË (50 %) TË NDARË SIPAS KRITEREVE TË VKM NR. 780, DATË 26.12.2018	99

VI) PJESËMARRJEN E STUDENTËVE NË PROJEKTE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR DHE MBËSHTETJEN PËR LËVIZSHMËRINË E TYRE;

101

TABELA NR. 19: MBI PJESËMARRJEN E STUDENTËVE NË PROJEKTE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR DHE MBËSHTETJEN PËR LËVIZSHMËRINË E TYRE	101
---	-----

BORDI I ADMINISTRIMIT

103

A) TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI IAL-NË LIDHUR ME STRUKTURËN E PËRGJITHSHME ORGANIZATIVE TË INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, NJËSITË PËRBËRËSE DHE AUTORITETET DREJTUESE PËRKATËSE ETJ.

103

TABELA NR. 20: MBI NUMRIN E PERSONELIT TË IAL-SË.	104
---	-----

B) TË DHËNA PËR PLANIN BUXHETOR AFATMESËM, PLANIN BUXHETOR NJËVJEÇAR DHE PLANIN STRATEGJIK TË ZHVILLIMIT TË INSTITUCIONIT.

106

TABELA NR. 21: PËR PLANIN BUXHETOR AFATMESËM	106
TABELA NR. 22: PËR PLANIN BUXHETOR NJËVJEÇAR	109
FINANCIMI NGA PROJEKTET E HUAJA MBULON RRETH 2% TE BUXHETIT TOTAL TË UV-SË.	110

REALIZIMIN FAKTIK TË PLANIT BUXHETOR TË VITIT PARAARDHËS BUXHETOR, SIPAS ZËRAVE TË BUXHETIT, PLANIN BUXHETOR TË VITIT PASARDHËS AKADEMIK, SI DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK NË VIJIM.

112

TABELA NR. 23: PËR REALIZIMIN FAKTIK TË PLANIT BUXHETOR TË VITIT PARAARDHËS BUXHETOR	112
TABELA NR. 24: PËR REALIZIMIN FAKTIK TË BUXHETIT NGA GRANTI I MËSIMDHËNIES PËR VITIN PARAARDHËS BUXHETOR (PROGRAMI BUXHETOR 09450, KAPITULLI 08, ARTIKULLI 600–606)	114
TABELA NR. 25: PËR REALIZIMIN FAKTIK TË BUXHETIT NGA GRANTI I PUNËS KËRKIMORE-SHKENCORE DHE I VEPRIMTARIVE KRIJUESE PËR VITIN PARAARDHËS BUXHETOR (PROGRAMI BUXHETOR 09770, KAPITULLIN 01, ARTIKULLI 604)	114



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

TABELA NR. 26: PËR REALIZIMIN FAKTIK TË BUXHETIT NGA GRANTIT I POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT PËR VITIN PARAARDHËS BUXHETOR (PROGRAMI BUXHETOR 09450, KAPITULLIN 01, ARTIKULLI 230-231)	115
TABELA NR. 27: PËR PLANIN BUXHETOR TË VITIT PASARDHËS AKADEMIK.	117
TABELA NR. 28: PËR TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK NË VIJIM:	118
<u>TË DHËNA MBI MOBILITETIN E PERSONELIT AKADEMIK TË FINANCUARA NGA IAL-JA APO TË REALIZUARA NË KUADËR TË PROJEKTEVE NDËRKOMBËTARE.</u>	125
TABELA NR. 29: MBI MOBILITETIN E PERSONELIT AKADEMIK	125
<u>F) TË DHËNA PËR PLOTËSIMIN E STANDARDEVE SHTETËRORE AKADEMIKE DHE INFRASTRUKTURE, NË PËRPTHJE ME KODIN E CILËSISË, KU PËRFSHIHEN NDRYSHIME NË MJEDISËT DIDAKTIKE, KËRKIMORE, POLITIKA TË SHPËRNDARJES SË FONDEVE NË FUNKSION TË PËRMIRËSIMIT TË CILËSISË, NUMRI I TEKSTEVE DHE INFRASTRUKTURA INFORMATIKE NË FUNKSION TË MËSIMIT, NË BASHKËPUNIM ME SENATIN AKADEMIK TË INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË.</u>	127
TABELA NR. 30: PËR PLOTËSIMIN E STANDARDEVE SHTETËRORE INFRASTRUKTURE:	127
<u>RISITË</u>	129



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

HYRJE

Raporti vjetor institucional i Universitetit Ismail Qemali të Vlorës për vitin akademik 2024-2025 pasqyron angazhimin e vazhdueshëm të UV-së për përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me udhëzimin nr. 5, datë 19.02.2018, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Viti akademik 2024-2025 shënon një etapë të rëndësishme zhvillimi për Universitetin “Ismael Qemali” të Vlorës, një institucion që vazhdon të konsolidojë rolin e tij si një qendër moderne, dinamike dhe e orientuar drejt ekselencës në arsimin e lartë. Ky raport vjetor paraqet arritjet, nismat inovative dhe rezultatet më domethënëse që kanë karakterizuar veprimtarinë e universitetit gjatë këtij viti, duke reflektuar përkushtimin e tij për cilësi, transparencë dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Gjatë kësaj periudhe, universiteti ka forcuar profilin e tij akademik dhe kërkimor, ka zgjeruar bashkëpunimet me partnerë kombëtarë e ndërkombëtarë dhe ka investuar në krijimin e një mjedisi studimi dhe pune gjithnjë e më mbështetës për studentët dhe stafin. Modernizimi i infrastrukturës, rritja e kapaciteteve profesionale dhe përmirësimi i shërbimeve institucionale janë disa nga drejtimet ku janë shënuar përparime të dukshme.

Raporti synon të ofrojë një pamje të qartë të transformimeve pozitive që kanë përforcuar imazhin dhe ndikimin e Universitetit “Ismael Qemali” në komunitetin akademik dhe atë shoqëror, duke dëshmuar vizionin e institucionit për të qenë një pol i rëndësishëm edukimi, inovacioni dhe zhvillimi në nivel rajonal dhe kombëtar.

Qëllimi kryesor i universitetit është të krijojë një mjedis që mbështet dhe integron mësimdhënien me standardet ndërkombëtare, përmirësimin e cilësisë akademike dhe forcimin e mundësive për kërkime shkencore. Ky raport mbështetet në planin strategjik të UV-së 2018-2024 të miratuar me vendim BA nr. 26, datë 08.11.2018, si dhe planin strategjik 2025-2030 të miratuar me VSA nr. 108, datë 20.11.2025.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

SENATI AKADEMIK

- a) Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit. Raporte të vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies, si dhe të kërkimit shkencor. Raporti specifikon strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse për këto realizime me referencë planin strategjik afatgjatë dhe afatshkurtër të IAL-së.

i. Fusha Mësimdhënia

Qëllimi: Politikat strategjike të mësimdhënies janë hartuar në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Arsimit të Lartë, vizionin e Universitetit të Vlorës (UV), dhe Planin Strategjik të UV. Ato fokusohen në rritjen e cilësisë së mësimdhënies, zhvillimin e kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizim, edukimin në vazhdimësi dhe ofrimin e shërbimeve komunitare.

Tabela nr. 1: Për Realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit

Mësimdhënia në Universitetin "Ismail Qemali" të Vlorës synon të ofrojë një përvojë akademike të cilësisë së lartë, të orientuar drejt aftësive, kompetencave dhe zhvillimit profesional të studentëve, në përputhje të plotë me prioritetet e Planit Strategjik të institucionit dhe me standardet kombëtare të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Qëllimet kryesore të mësimdhënies përqëndrohen në modernizimin e praktikave pedagogjike, forcimin e kulturës së cilësisë dhe orientimin e proceseve akademike drejt rezultatit të të nxënit, duke synuar krijimin e profesionistëve të aftë të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik e shoqëror të vendit dhe të konkurrojnë në tregun global të punës.

Në përputhje me standardet kombëtare të cilësisë, mësimdhënia në UV udhëhiqet nga parimet e transparencës, përmirësimit të vazhdueshëm si dhe rritjes akademike. Institucioni siguron që programet e studimit, planprogramet, metodat didaktike dhe format e vlerësimit të jenë të dokumentuara, të monitoruara dhe të rishikohen rregullisht për të reflektuar kërkesat bashkëkohore të tregut të punës, zhvillimit shkencor dhe nevojave të studentëve.

Një fokus i rëndësishëm mbetet fuqizimi i stafit akademik përmes trajnimeve, aktiviteteve kërkimore dhe përfshirjes në iniciativa ndërdixhinale, duke garantuar rritjen e kapaciteteve profesionale dhe pedagogjike.

Në këtë kuadër, Universiteti i Vlorës e konsideron ndërkombëtarizimin si një komponent thelbësor të zhvillimit të mësimdhënies dhe cilësisë akademike. Procesi i ndërkombëtarizimit synon të integrojë perspektiva globale në mësimdhënie, të zgjerojë bashkëpunimet me institucione të huaja të arsimit të lartë, të rrisë mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik, si dhe të përfshijë praktikën më të mira ndërkombëtare në programet e studimit. Përmes projekteve ndërkombëtare, marrëveshjeve bilaterale dhe pjesëmarrjes në rrjete akademike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

evropiane, UV synon të rrisë cilësinë e ofertës së vet arsimore dhe të promovojë kulturën e inovacionit dhe të diversitetit kulturor në mjedisin universitar.

Universiteti ka arritur të implementojë një plan të integruar dhe të strukturuar të mësimdhënies, duke siguruar një nivel të lartë të organizimit akademik, transparencës dhe mbështetjes për studentët dhe personelin akademik. Realizimi i objektivave strategjike kanë kontribuar në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe promovimin e standardeve të larta akademike.

Tabela 1: Për realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e mësimdhënies

Objektivi 1: Në funksion të arritjes së qëllimit për fushën e mësimdhënies

Nr.	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Fakulteti / Drejtoria/ Sektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
Fakulteti i Shëndetit						
1.	Planifikimi i kohës vjetore të punës së personelit akademik	Organizimi është kryer duke harmonizuar ngarkesën për mësimdhënin e normuar, kërkimin shkencor dhe mbështetjen institucionale	DKSH	Formalizimi nëpërmjet marrëveshjes që lidhet me fillimin e vitit të ri akademik midis personelit akademik dhe përgjegjësit të departamentit	Tetor 2024	
2.	Realizimi i kohës vjetore të punës së personelit akademik		DKSH	Dorëzimi i marrëveshjes që lidhet me fillimin e vitit të ri akademik midis personelit akademik dhe përgjegjësit të departamentit për ngarkesën e realizuar mësimdhënin e normuar, kërkimin shkencor dhe mbështetjen institucionale	Korrik 2025	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

Nr.	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Fakulteti / Drejtoria/ Sektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
3.	Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet pyetësorit të studentit	Stafi akademik angazhohet në shpërndarjen e pyetësorit dhe në plotësimin e tij nga cdo student	Pyetësi administrohet nga Zyra e Sigurimit të Cilësisë UV	Procesi është realizuar me plotësimin e pyetësorit nga studentët në cdo sezon të vitit akademik	Tetor 2024	Rezultatet e vlerësimit pasqyrohen në performancën vjetore të stafit akademik që hartohet për cdo pedagog nga drejtuesi i departamentit, sipas formatit të miratuar nga Senati Akademik i UV. Performanca hartohet në fund të cdo viti akademik dhe nënshkruhet nga pedagogu përkatës dhe drejtuesi i departamentit. Performanca dorëzohet te Zyra e Burimeve Njerëzore UV.
4.	Rishikim dhe dorëzim i syllabusit të lëndëve nga titullari i lëndës. Diskutime dhe me lektorët e lëndës.	Titullarët e lëndëve angazhohen në rishikim dhe dorëzimin e syllabusit të lëndës para fillimit të vitit akademik. Cdo ndryshim bëhet në përputhje me normativën dhe me justifikime mbështetëse nga titullari.	DKSH	Dorëzimi i syllabusit në kohë para fillimit të vitit akademik, i nënshkruar nga titullari, lektorët dhe drejtuesi i departamentit	Tetor 2024	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

Nr.	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Fakulteti / Drejtoria/ Sektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
5.	Përgatitja e teksteve mësimore që përdoren si literaturë bazë	Pedagogu i lëndës bën kërkesë në departamentin përkatës një sezon para zhvillimit të modulit që do të kërkoj për miratim si literaturë bazë. Së bashku me kërkesën, ku ka shprehur arsyen dhe nevojën për këtë literaturë bazë, dorëzon dhe materialin formatin draft për tu rishikuar dhe vlerësuar nga komisioni i departamentit ku ka aplikuar	DKSH	Literaturë bazë e miratuar, me standarte dhe e vlerësuar paraprakisht nga komisioni vlerësuar. Literatura e miratuar pasqyrohet në seksionin përkatës të syllabusit të lëndës.	Një semestër para zhvillimit të modulit përkatës për të cilin kërkohet miratimi i literaturës së detyruar	
6.	Hartimi i tezave të provimeve të lëndëve nga lektori i lëndës para cdo provimi	Hartim në kohë, dhe nënshkrimin paraprak të tezës nga titullari dhe drejtusi i departamentit	DKSH	Transparencë dhe barazi për studentët Përmirësim të cilësisë së mësimdhënies	Para cdo provimi të përfunduar apo final	
7	Erasmus +	Aplikimi i stafit në programet Erasmus në Teaching	DKSH + Zyra e marrëdhënieve me jashtë në UV	Po	2024 -2025	6 staf akademik
8	Evidentimi i të rejave shkencore në fushën e kujdesjeve infermiere dhe përfshirja e tyre në procesin e mësimdhënies	Përfshirja në leksionet e studimeve më të fundit në fushën e kujdesjeve infermiere	Stafi akademik	Po	2024 -2025	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

Nr.	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Fakulteti / Drejtoria/ Sektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
9	Simulimi i situatave	Përdorimi i laboratorit simulator dhe didaktik për të ndihmuar studentët në ndërtimin e planeve të kujdesjeve infermiore në mënyrë të pavarur	Stafi akademik infermior Stafi jo akademik mbwshtetws	Po	2024 -2025	Orët e laboratorit në INF 161 dhe INF 162 dhe praktika profesionale është realizuar në orare të parapërcaktuar a në laboratorin simulator.
10	Këshillimi i studentëve	Këshilltari akademik realizon takime të herë pas hershme me studentët e viteve të ndryshme për ti orientuar në funksion të mësimdhënies	Këshilltari akademik	Po	2024-2025	Emërohet në fillim të vitit akademik
11	Koordinimi i praktikës	Koordinatori i praktikës krijon urë lidhëse midis institucioneve spitalore dhe fakultetit	Koordinatori i praktikës	Po	2024-2025	Emërohet në fillim të vitit akademik
12	Plotësimi i standarteve për numrin e studentëve në grupet e laboratoreve, praktikës dhe seminareve	Ndarja e studentëve në grupe laborator, praktike dhe seminare në funksion të mësimnxënies duke zbatuar standartet	Sekretaria mësimore	Po	Në fillim të vitit akademik	1 grup laborator/praktike nuk ka më shumë se 20 studentë 1 grup seminari nuk ka më shumë se 25 studentë
13.	Realizimi i ngarkesës mësimore.	Zbatimi i orarit dhe përcaktimi paraprak i zëvendësimit të ditëve të pushimit	Departamenti dhe sekretaria mësimore	Po	2025	
14.	Këshilltari akademik	Këshillimi, orientimi, suportimi dhe mbështetja e studentëve	Departamenti dhe këshilltari akademik	Po	2024-2025	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

Nr.	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Fakulteti / Drejtoria/ Sektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
15.	Koordinatori i praktikave mësimore.	Shoqërimi i studentëve në ambjentet spitalore.	Departamenti dhe koordinatori i praktikave	Po	2024-2025	
16.	Përfshirja e studentëve në aktivitetet promocionale dhe kërkimin shkencor.	Angazhimi i studentëve në promovim dhe kryerjen e procedurave infermierore gjatë këtyre ditëve.	Gjithë stafi i departamentit	Po	2024-2025	
17.	Studentët tanë që ndjekin programet Erasmus	Ndjekja e programeve learning dhe training	DI/FSH	Po	2024 - 2025	
18.	Simulimi i situatave spitalore	Përdorimi i laboratorit simulator për t'ju ardhur në ndihmë studentëve në këtë drejtim	Stafi akademik i DI, laborantët e DI.	Po	2024-2025	IN 161 INF 162 INF 300 INF 500
19.	Respektimi i standarteve për numrin e studentëve në laboratore, seminare e praktika.	Ndarja e studentëve në grupe bazuar në standartin përkatës	Sekretaria mësimore	Po	Në fillim të vitit akademik	1 grup laborator/praktikë nuk ka më shumë se 20 studentë
20.	Trajnimi i stafit	Angazhimi i stafit në këto trajnime	Zyra e marrëdhënieve me jashtë	Po	Erasmus +	3 staf akademik
21	Planifikimi i kohës vjetore të punës së personelit akademik	Organizimi është kryer duke harmonizuar ngarkesën për mësimdhënien e normuar, kërkimin shkencor dhe mbështetjen institucionale	Qendra Kërkimore Shkencore e Shëndetit Publik	Formalizimi nëpërmjet marrëveshjes që lidhet me fillimin e vitit të ri akademik midis personelit akademik dhe përgjegjësit të departamentit	Tetor 2024	Planifikimi i kohës vjetore të punës së personelit akademik
22	Realizimi i kohës vjetore të punës së personelit akademik		Qendra Kërkimore Shkencore e Shëndetit Publik	Dorëzimi i marrëveshjes që lidhet me fillimin e vitit të ri akademik midis personelit akademik dhe përgjegjësit të	Korrik 2025	Realizimi i kohës vjetore të punës së personelit akademik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

Nr.	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Fakulteti / Drejtoria/ Sektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
				departamentit për ngarkesën e realizuar mësimdhënies në normuar, kërkimin shkencor dhe 23mbështetjen institucionale		
23	Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet pyetësorit të studentit	Stafi akademik angazhohet në shpërndarjen e pyetësorit dhe në plotësimin e tij nga cdo student	Pyetësi administrohet nga Zyra e Sigurimit të Cilësisë UV	Procesi është realizuar me plotësimin e pyetësorit nga studentët në cdo sezon të vitit akademik	Tetor 2024	Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet pyetësorit të studentit
24	Rishikim dhe dorëzim i syllabusit të lëndëve nga titullari i lëndës. Diskutime dhe me lektorët e lëndës.	Titullarët e lëndëve angazhohen në rishikim dhe dorëzimin e syllabusit të lëndës para fillimit të vitit akademik. Cdo ndryshim bëhet në përputhje me normativën dhe me justifikime mbështetëse nga titullari.	Qendra Kërkimore Shkencore e Shëndetit Publik	Dorëzimi i syllabusit në kohë para fillimit të vitit akademik, i nëshkruar nga titullari, lektorët dhe drejtuesi i departamentit	Tetor 2025	Rishikim dhe dorëzim i syllabusit të lëndëve nga titullari i lëndës. Diskutime dhe me lektorët e lëndës.
25	Përgatitja e teksteve mësimore që përdoren si literaturë bazë	Pedagogu i lëndës bën kërkesë në departamentin përkatës një sezon para zhvillimit të modulit që do të kërkoj për miratim si literaturë bazë. Së bashku me kërkesën, ku ka shprehur arsyen dhe nevojën për këtë literaturë bazë, dorëzon dhe materialin formativ draft për tu rishikuar dhe vlerësuar nga komisioni i departamentit ku ka aplikuar	Qendra Kërkimore Shkencore e Shëndetit Publik	Literaturë bazë e miratuar, me standarte dhe e vlerësuar paraprakisht nga komisioni vlerësuar.		Përgatitja e teksteve mësimore që përdoren si literaturë bazë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

Nr.	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Fakulteti / Drejtoria/ Sektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
26	Zhvillimi i moduleve në gjuhën angleze apo gjuhë të tjera të BE	Organizimi i mbledhjeve në nivel departamenti ku diskutohet se cili nga anëtarët e stafit është në gjendje dhe dëshiron të angazhohet për ofrimin e moduleve në gjuhë të huaj, organizim të workshopeve në kuadër të mobiliteteve Erasmus+	Qendra Kërkimore Shkencore e Shëndetit Publik	Hartimi i modulit pëkatës në gjuhën e huaj nga ana e pedagogut dhe dorëzimi në departamentin përkatës ku ofrohet programi i studimit	Në fillim të vitit akademik	Zhvillimi i moduleve në gjuhën angleze apo gjuhë të tjera të BE
27	Evidentimi i te rejave shkencore dhe përfshirja e tyre në procesin e mësimdhënies	Përfshirja në leksione e studimeve më të fundit në fushën e kujdesjeve infermiore	Stafi akademik i D.I.	Po	2024-2025	Evidentimi i te rejave shkencore dhe përfshirja e tyre në procesin e mësimdhënies
Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore						
1	Organizimi i mësimdhënies nga pedagog të huaj	Zhvillimi i leksioneve nga pedagog të huaj të cilët kanë zhvilluar mobilitet pranë FSHTN	FSHTN	2 Pedagogë nga Universitete evropiane kanë zhvilluar mobilitete pranë UV dhe kanë zhvilluar leksione. Kjo është në përputhje me objektivin strategjik Nr. 2.	2024-2025	
2	Organizimi i mësimdhënies përmes leksioneve, seminareve, praktikave profesionale etj.	Zhvillimi i leksioneve dhe të gjitha procedurave mësimore sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi.	FSHTN	Në bazë të planit strategjik FSHTN ka realizuar të gjitha aktivitetet sipas parashikimeve.		Organizimi i mësimdhënies përmes leksioneve, seminareve, praktikave profesionale etj.
3	Mobiliteti i studentëve	Mobilitet i studentëve nga UV jashtë dhe anasjelltas	FSHTN	14 studentë të Fakultetit kanë zhvilluar mobilitet	2024 - 2025	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

Nr.	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Fakulteti / Drejtoria/ Sektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
				jashtë Shqipërisë ndërsa 1 student ka zhvilluar mobilitet pranë UV-së. Kjo është në përputhje me objektivin strategjik Nr. 2.		
4	Mobiliteti I personelit akademik	Mobilitet i personelit akademik nga UV jashtë dhe anasjelltas	FSHTN	9 personel akademik të Fakultetit kanë zhvilluar mobilitet jashtë Shqipërisë ndërsa 2 staf akademik i huaj kanë zhvilluar mobilitet pranë UV-së. Kjo është në përputhje me objektivin strategjik Nr. 2.		
5	Përfshirjen e stafit akademik në veprimtari të përbashkëta kërkimore shkencore ndërkombëtare.	Përfshirjen e stafit akademik në artikuj të përbashkët Kërkimore shkencor me kerkues shkencor nga universitete ndërkombëtare.	FSHTN	Personel akademik janë përfshirë në artikuj kërkimor shkencor të përbashkët me kerkues shkencor nga universitete ndërkombëtare. Kjo është në përputhje me objektivin strategjik Nr 3.	2024-2025	
6	Investime në bazë materiale dhe laboratorike për implementim të metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies	Rritja e niveli të mesimdhënies dhe mesimnxënies përmes aplikimit të metodave inovative digjitale dhe mjeteve	FSHTN	Në bazë të planit strategjik FSHTN ka realizuar të gjitha aktivitetet sipas parashikimeve. Përfuthet me objektivin strategjik Nr. 1	2024-2025	
7	Organizimi i mësimdhënies përmes leksioneve, seminareve, laboratorëve,	Zhvillimi I leksioneve dhe të gjitha procedurave mësimore sipas parashikimeve në	FSHTN		2024-2025	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

Nr.	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Fakulteti / Drejtoria/ Sektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
	praktikave profesionale etj.	legjislacionin në fuqi				
8	Rishikim dhe dorëzim I syllabusit të lëndëve nga titullari lëndës. Diskutime dhe me lektorët e lëndës.	Titullarët e lëndëve angazhohen në rishikim dhe dorëzimin e syllabusit të lëndës para fillimit të vitit akademik. Cdo ndryshim bëhet në përputhje me normativën dhe me justifikime mbështetëse nga titullari.	FSHTN	Dorëzimi I syllabusit në kohë para fillimit të vitit akademik, i nëshkruar nga titullari, lektorët dhe drejtuesi I departamentit	2024-2025	
9	Ngritja e grupeve të punës në departament për çështje të ndryshme në funksion të procesit të mësimdhënies.	Ne Departament janë ngritur grupe pune në funksion të përbushjes së detyrimeve akademike të reflektuara në planin strategjik.	FSHTN	Në përputhje me Planin Strategjik të Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë.	2024-2025	
10	Përgatitja e teksteve mësimore që përdoren si literaturë bazë	Stafi akademik përgatit dhe dorëzon në njësinë bazë literaturën përkatëse për lëndët që zhvillon. Gjithashtu kjo literaturë miratohet nga komisioni i njësive bazë për literaturën dhe përcillet formalisht në Dekanat dhe më pas në Rektorat	FSHTN	Literatura pasqyrohet në syllabus dhe iu shpërndahet studentëve	2024-2025	
11	Udhëheqja e praktikave mësimore dhe profesionale	Hartim në kohë, dhe nënshkrimi paraprak të tezës nga titullari dhe drejtuesi I departamentit	FSHTN	Përmirësim I cilësisë së vlerësimit dhe rritje e transparencës	2024-025	
12	Udhëheqja dhe mbrojtja e temave të diplomave për	Udhëheqja e planifikuar dhe e drejtuar nga pedagogët	Njësitë bazë të FSHTN	Përmirësim i cilësisë së vlerësimit dhe rritje e	Korrik, Shtator 2025	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

Nr.	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Fakulteti / Drejtoria/ Sektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
	studentët që ndjekin Ciklin e dytë të Studimeve Master	udhëheqës për temat e iplomave Mbrojta e temave nëpërmjet komisioneve të ngritura		transparencës dhe kontributit shkencor të studentëve		
13	Vlerësimi vjetor i performancës së punës për secilin pedagog.		Njësitë Bazë të FSHTN	Plotësimi I formatit të performancës sipas formatit të UV.	Shtator 2025	
14	Hapja e programeve të reja	DP në Programim Web dhe dizajnim digjital, Program profesional (niveli 5 i Kornizës së Kualifikimeve)	DSHK FSHTN	Urdher Hapje Nr.283,date 30.06.2025 MAS , Nr.4102/2.Prot	30.06.2025	
15	Hapja e programeve të reja	BSc in Computer Engineering, Cikli i parë i studimit (niveli 6 i Kornizës së Kualifikimeve)	DSHK FSHTN	Miratur nga MASR Urdher Nr.269	23.06.2025	
16	Hapja e programeve të reja	Bachelor në Matematikë Informatikë	DMF (departamenti Matematike-Fizike) FSHTN	Miratur nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me shkresën, Nr. 4736/1	23.07.2025	
17	Hapja e programeve të reja	DP Specialist në Shërbime dhe operacioneve Detare	Shkenca Detare FSHTN			
18	Hapja e programeve të reja	Master i Perbashket Shkencor në Anglisht Menaxhimi dhe Mbrojtja e Mjedisit Detar – Join Msc Maritime Environment Protection And Management Mep&M In English	Shkenca Detare FSHTN	Miratur nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me shkresën, Nr. 456,	14.8.2023	
Fakulteti i Shkencave Humane						
1	Planifikimi i kohës vjetore të punës së	Për çdo departament të FSHH është	FSHH	Plotësimi i Evidencave	31 Tetor 2024	Është realizuar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

Nr.	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Fakulteti / Drejtoria/ Sektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
	personelit akademik	planifikuar ngargesa e personelit akademik për 2024-2025		përkatëse për planifikimin e ngarkesës mësimore, brenda dhe jashtë auditorit, kërkimin shkencor, kontributin instituional dhe kontributin profesional		plotësisht
2	Realizimi i kohës vjetore të punës së personelit akademik	Për çdo departament të FSHH është formalizuar realizimi i ngarkesës së punës e personelit akademik për 2024-2025	FSHH	Plotësimi i Evidencave përkatëse për realizimin e ngarkesës mësimore, brenda dhe jashtë auditorit, kërkimin shkencor, kontributin instituional dhe kontributin profesional; regjistri dhe evidencat shkresore (shtojcat e diplomave, kërkimi shkencor, etj)	Korrik 2025	Është realizuar plotësisht
3	Përgatitja dhe dorëzimi dhe përcjellja e syllabuseve të lëndëve nga titullari i lëndës. Diskutime dhe me lektorët e lëndës.	Titullarët e lëndëve angazhohen në përgatitjen dhe dorëzimin e syllabusit të lëndës para fillimit të vit akademik. Syllabuset miratohen për çdo departament nga përgjegjësi I Njesisë Bazë dhe përcillen në Dekanat, në formë shkresore dhe elektronike.	Njësiti Bazë të FSHH, Dekanati i FSHH	Dorëzimi i syllabusit në kohë para fillimit të vitit akademik, i nëshkruar nga titullari, lektorët dhe drejtuesi i departamentit	Tetor 2024	Është realizuar plotësisht
4	Përgatitja e teksteve mësimore që përdoren si literaturë bazë	Stafi akademik përgatit dhe dorëzon në njësinë bazë literaturën përkatëse për lëndët që zhvillon. Gjithashtu kjo literaturë miratohet nga	Njësiti Bazë të FSHH, Dekanati i FSHH	Literatura pasqyrohet në syllabus dhe iu shpërndahet studentëve	Tetor 2024	Është realizuar plotësisht



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

Nr.	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Fakulteti / Drejtoria/ Sektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
		komisioni i njësive bazë për literaturën dhe përcillet formalisht në Dekanat dhe më pas në Rektorat				
5	Dorëzimi i planeve vjetore akademike	Njësiti Bazë, ridërgojnë planet vjetore akademike në Dekanat, miratohen nga Dekani dhe përcillen për miratim në Senatin Akademik. Planet dorëzohen çdo fillim viti akademik, pasi mund të pasqyrohen ndryshimet e tyre sipas rishikimit të miratuar (20%)	Njësiti Bazë të FSHH, Dekanati i FSHH	Fakulteti ka plane të miratuara	Tetor 2024	Eshtë realizuar plotësisht
6	Përgatitja e orareve mësimore simestrale dhe vjetore	Njësiti Bazë janë përgjegjëse për hartimin e orarit mësimor përpara çdo simestri, miratimin e tij dhe përcjelljen për miratim në Dekanat dhe përcilen në Rektorat. Studentët regjistrohen në SIUV për frekuentimin e lëndëve	Njësiti Bazë të FSHH, Dekanati i FSHH Sektori IT	Lëndët zhvillohen në bazë të orareve dhe studentët janë të regjistruar për ndjekjen dhe vlerësimin e lëndëve.	Tetor 2024	Eshtë realizuar plotësisht
7	Këshillimi i studentëve	Këshilltari akademik realizon takime të herë pas herëshme me studentët e viteve të ndryshme për t'i orientuar në funksion të mësimdhënies	Këshilltari akademik i çdo njësie bazë Zyra studentore pranë FSHH	Studentët janë të orientuar dhe nevojat e tyre të mësimdhënies janë të plotësuara	2024-2025	Eshtë realizuar plotësisht
8	Realizimi i mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve	Aplikimi i stafit dhe studentëve të FSHH në programet Erasmus + , ose nëpërmjet projekteve	FSHH Zyra e marrëdhënieve ndërkombëtare	Ndërkombëtarizimi I UV	2024 -2025	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

Nr.	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Fakulteti / Drejtoria/ Sektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
		dhe marrëveshjeve të nënshkruara	dhe projekteve UV			
9	Udhëheqja e praktikave mësimore dhe profesionale	Udhëheqësit e praktikave mbështesin, udhëzojnë dhe monitorojnë praktikatat e studentëve, bazuar në Marrëveshjet e Fakultetit/UV me institucionet ku zhvillohen praktikatat	Njësitë Bazë të FSHH	Realizimi i praktikave mësimore dhe profesionale	Simestri i dytë 2024-2025	Realizimi i praktikave dokumentohet dhe përcillet në fund të çdo viti akademik
10	Hartimi i tezave të provimeve të lëndëve nga lektori i lëndës para çdo provimi dhe i tezave të provimit final të formimit.	Hartim në kohë, dhe nënshkrimi paraprak të tezës nga titullari dhe drejtusi i departamentit	Njësitë Bazë të FSHH	Përmirësim i cilësisë së vlerësimit dhe rritje e transparencës	Përpara provimeve të pjesshme dhe finale Në përfundim të studimeve	Realizuar plotësisht
11	Udhëheqja dhe mbrojtja e temave të diplomave për studentët që ndjekin Ciklin e dytë të Studimeve Master	Udhëheqja e planifikuar dhe e drejtuar nga pedagogët udhëheqës për temat e diplomave Mbrojtja e temave nëpërmjet komisioneve të ngritura	Njësitë bazë të FSHH	Përmirësim i cilësisë së vlerësimit dhe rritje e transparencës dhe kontributit shkencor të studentëve	2024-2025	Realizuar plotësisht
12	Përdorimi i infrastrukturës së përshtatshme në drejtim të mësimdhënies	Realizimi i mësimdhënies bazuar në metoda interaktive dhe audiovizuale	FSHH	Rritja e cilësisë së mësimdhënies bazuar në metoda interaktive dhe bashkëkohore	2024-2025	Pjesa më e madhe e klasave është e pajisur me videoprojektor dhe internet Kërkohet pajisja e të gjitha klasave të FSHH me videoprojektor fix



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

Nr.	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Fakulteti / Drejtoria/ Sektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
13	Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet pyetësorit të studentit	Studentët plotësojnë pyetësin e dërguar për çdo semester. Pyetësi administrohet dhe analizohet nga Zyra e Sigurimit të Cilësisë UV.	SSBCA	Plotësimi I pyetësorëve	Shtator 2025	Rezultatet e vlerësimit diskutohen në takime me stafin dhe pasqyrohen në performancën vjetore të stafit akademik.
14	Vlerësimi vjetor i performancës së punës për secilin pedagog.	Performanca hartohet në fund të çdo viti akademik dhe nënshkruhet nga pedagogu përkatës dhe drejtuesi i njësive bazë. Performanca dorëzohet te Zyra e Burimeve Njerëzore UV.	Njësitë Bazë të FSHH	Plotësimi I formatit të performancës sipas formatit të UV.	Shtator 202	Është Realizuar
Fakulteti Ekonomik						
1	Rishikimi dhe përditësimi i programeve mësimore në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe standardet e ECTS	- Hartimi i një analize të tregut të punës - Përfshirja e përfaqësuesve të bizneseve në procesin e konsultimit të kurrikulave - Përditësimi i syllabuseve për çdo lëndë.	Departamenti i Ekonomiksit	Në përputhje me objektivin strategjik për 'Përmirësimin e cilësisë akademike dhe përputhjen me nevojat e tregut të punës'	Dhjetor 2025	Kërkon bashkëpunim më të gjerë me sektorin privat
2	Përdorimi i metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe vlerësimit	- Trajnime për stafin akademik mbi mësimdhënien digjitale dhe metodat interaktive - Zbatimi i mësimdhënies përmes studimeve të rasteve dhe simulimeve ekonomike.	Departamenti i Ekonomiksit Zyra e Zhvillimit Akademik	Në linjë me objektivin strategjik për 'Digjitalizimin dhe inovacionin në procesin mësimor'	Qershor 2026	Pjesërisht e realizuar; kërkohet pajisje teknologjike shtesë
3	Rritja e ndërkombëtarizimit në mësimdhënie	- Organizimi i leksioneve të hapura me pedagogë nga universitete partnere	Departamenti i Ekonomiksit Zyra e Marrëdhënieve	Në përputhje me objektivin strategjik për 'Ndërkombëtarizimin	Qershor 2026	Po forcohen kontaktet me universitetet partnere në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

Nr.	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Fakulteti / Drejtoria/ Sektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
		- Nxitja e mobilitetit të stafit dhe studentëve përmes programeve Erasmus+	me Jashtë	e arsimit të lartë'		rajon dhe BE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

ii. Fusha Kërkimi Shkencor dhe veprimtaria krijuese dhe inovacioni

Qëllimi: Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë (UV) synon të zhvillojë dhe forcojë kërkimin shkencor në përputhje me prioritetet strategjike të institucionit dhe politikat kombëtare të arsimit të lartë. Qëllimi është nxitja e ekselencës kërkimore, rritja e produktivitetit shkencor të stafit akademik dhe përfshirja në projekte kombëtare e ndërkombëtare që mbështesin inovacionin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Kërkimi shkencor dhe veprimtaria krijuese e inovative përbëjnë një shtyllë themelore të zhvillimit institucional të universitetit. UV-ja synon të nxisë prodhimin e njohurive të reja, të forcojë kapacitetet kërkimore dhe të mbështesë zhvillimin e projekteve që kontribuojnë në avancimin shkencor, teknologjik dhe në rritjen e impaktit akademik. Përmes krijimit të një mjedisi bashkëpunues, promovimit të bashkëpunimeve ndërdisiplinore, pjesëmarrjes aktive në projekte kombëtare e ndërkombëtare dhe inkurajimit të iniciativave krijuese, universiteti synon të rrisë ndikimin shkencor e inovativ në zhvillimin rajonal, kombëtar dhe në hapësirën evropiane të kërkimit.

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë mbetet i përkushtuar ndaj stimulimit të kreativitetit, ekselencës kërkimore dhe zbatimit të inovacioneve në funksion të komunitetit, ekonomisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Tabela 2: Për realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushin e kërkimit shkencor dhe Inovacionit

Objektivi 1: Në funksion të arritjes së qëllimit për fushën e kërkimit shkencor

Nr.	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Fakulteti / Drejtoria/ Sektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
1	Zhvillimi i sistemit të menaxhimit të kërkimit shkencor	Krijimi i bazës së të dhënave për publikime, konferenca, projekte dhe CV akademike	SKSHP, Fakultetet	Në zbatim	2025	Sistemi po zhvillohet dhe do të integrohet me databazat ekzistuese të UV



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

Nr.	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Fakulteti / Drejtoria/ Sektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
2	Mbështetja e kërkimit shkencor të stafit akademik	Financim për botime dhe pjesëmarrje në konferenca, mbështetje në organizimin e aktiviteteve kërkimore shkencore/konferencave, simpoziumeve	SKSHP / Drejtoria e Financës / Fakultetet	Realizuar	2025	Aktivitetet u mbështetën plotësisht sipas buxhetit dhe planeve vjetore
3	Nxitja e inovacionit dhe transferimit të njohurive	Krijimi i qendrave kërkimore, licencimi laboratorëve, patentime	SKSHP / FSHTN	Në proces	2025-2026	Procesi i akreditimit të laboratorëve dhe regjistrimi i markave po zhvillohet
4	Mbështetja e doktorandëve në kërkim	Organizimi i trajnimeve metodologjike dhe webinareve/aktivitete lidhur me kërkimin shkencor	SKSHP / FSHH	Në proces	2025-2026	Trajnime të planifikuara, pjesëmarrje aktive e doktorandëve në projektet kërkimore
5	Forcimi i bashkëpunimeve kombëtare e ndërkombëtare	Pjesëmarrje në projekte Horizon, Erasmus+, Interreg, READ	SKSHP / DKZHMT	Realizuar	2025	Projekte të aprovuara dhe aktive, me pjesëmarrje të stafit akademik dhe studentëve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

SEKTORI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

Nr.	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Fakulteti / Drejtoria/ Sektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
6	Rritje e standardit të punimeve shkencore	Kontroll antiplagjiaturë Etikë dhe standarde ndërkombëtare Publikime në revista indeksuara Zhvillim kapacitetesh dhe projekte	SKSHP FSHTN FSHH FE FSH	Në proces /Në zbatim	2025	Aktivitetet po monitorohen sipas planeve strategjike; pjesëmarrja në konferenca dhe publikime po rritet gradualisht

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë (UV-ja) ka ndërmarrë një sërë masash për zhvillimin dhe forcimin e kërkimit shkencor dhe inovacionit, në përputhje me planin strategjik dhe objektivat e Institucionit. Për secilin objektiv, raporti i realizimit është si vijon:

1. **Zhvillimi i sistemit të menaxhimit të kërkimit shkencor**

UV-ja ka krijuar një bazë të dhënash për publikime, konferenca, projekte dhe CV akademike. Ky sistem po zhvillohet dhe monitorohet nga Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Projekteve (SKSHP) në bashkëpunim me fakultetet, duke garantuar integritimin e të dhënave dhe lehtësimin e menaxhimit të informacionit kërkimor. Realizimi është në zbatim dhe pritet të përfundojë brenda vitit 2025.

2. **Mbështetja e kërkimit shkencor të stafit akademik**

UV-ja ka siguruar financim për botime dhe për pjesëmarrje në konferenca, si dhe mbështetje në organizimin e aktiviteteve kërkimore dhe simpoziumeve shkencore. Aktivitetet janë realizuar plotësisht sipas planit, me mbështetje të drejtpërdrejtë nga SKSHP, Drejtoria e Financës dhe fakultetet përkatëse, duke garantuar përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë shkencore.

3. **Nxitja e inovacionit dhe transferimit të njohurive**

